

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 24.01.2026

Problemi 1

Pjesa a) dhe pjesa b) e detyrës 1 janë të ndara.

- a) Gjatë harmonizimit të ekstraktit bankar me librin e arkës të Alba SH.P.K. për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2025, ju keni vërejtur informatat e mëposhtme:

Përshkrimi	€
i) Saldo sipas ekstraktit bankar më 31 dhjetor 2025	(403,218)
ii) Çeqe të lëshuara por të paparaqitura deri më 31 dhjetor 2025	188,892
iii) Interesi për overdraftin i regjistruar nga banka më 2 janar 2026 ishte regjistruar gabimisht në librin e arkës më 31 dhjetor 2025. Ky interes ishte për muajin janar 2026.	59,343
iv) Çeqet e arkëtuara më 30 dhe 31 dhjetor 2025 nuk ishin depozituar në bankë deri më 3 janar 2026.	125,300
v) Një çek ishte dërguar në bankë për arkëtim më 28 dhjetor 2025 dhe ishte regjistruar në librin e arkës. Megjithatë, banka e kreditoi atë më 1 janar 2026.	98,250
vi) Abonimi për një revistë u pagua nga banka, sipas udhëzimit për debitim direkt më 1 dhjetor 2025. Ky transaksion ende nuk është regjistruar në librin e arkës	1,572
vii) Një çek për pagese të cilit i kishte kaluar afati ishte anuluar. Nuk është bërë asnjë korigjim në librin e arkës për këtë. Çeku përfshihet në pikën (ii) më sipër.	2,500
viii) Një çek i pranuar më 21 dhjetor 2025 ishte regjistruar gabimisht në anën kreditore të librit të arkës	3,750
ix) Një çek i lëshuar për një furnitor kishte skaduar më 2 janar 2026.	12,500
x) Një çek në vlerë prej 62,500€, i tërhequr nga kompania për pagesën e një mjeti të ri, ishte regjistruar gabimisht në librin e arkës si	6,250
xi) Një çek i lëshuar nga kompania është regjistruar në anën kreditore të ekstraktit bankar.	6,600

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e harmonizimit bankar më 31 dhjetor 2025 dhe llogaritni saldon e pakorigjuar të arkës.

(10 pikë)

Korrigjime në librin e arkës

Gjendja bankare sipas librit të arkës (overdraft)	(390,781)
(para rregullimeve/korrigjimeve të mësipërme – shifër balancuese)	
Interesi bankar i regjistruar gabimisht në librin e arkës	59,343
Çeku i anuluar	2,500
Gabim në regjistrimin e çekut (62,500 – 6,250)	(56,250)
Abonimi për revista tani është regjistruar	(1,572)
Çeku i pranuar, i regjistruar gabimisht në librin e bankës (3,750 + 3,750)	7500
Total korrigjimet	<u>11,521</u>
Saldoja e korigjuar sipas librit të arkës (mbitërheqje)	(379,260)

Pasqyra e harmonizimit bankar më 31 dhjetor 2022

Saldo e mbitërhequr sipas ekstraktit bankar	(403,218)
Korrigjimet:	
Çeqe të lëshuara, por të paparaqitura (188,892 – 2,500)	(186,392)
Çek i lëshuar, i kredituar gabimisht në ekstraktin bankar (6,600 + 6,600)	(13,200)
Arkëtimi i pranuar, por i pa depozituar në bankë	125,300
Çek i pa kredituar nga banka	<u>98,250</u>
Saldo e korigjuar e ekstraktit bankar	<u>(379,260)</u>

b) Kontabilisti i Albani SH.P.K. ka përgatitur një bilanc vërtetues dhe ka vënë re se totali i saldove debitore është 691,680€ ndërsa totali i saldove kreditore është 689,540€.

Gjatë hetimit, ai zbulon gabimet e mëposhtme në regjistrime:

- i) Shuma totale e blerjeve gjatë periudhës ishte regjistruar 80€ më pak se vlera e duhur, por totali i detyrimeve tregtare ishte saktë i regjistruar.
- ii) Totali i shpenzimeve për telefon ishte regjistruar 800€ mbi shumën e saktë, megjithëse totali i detyrimeve të pagueshme ishte regjistruar saktë.
- iii) Kthimet e blerjeve prej 440€ ishin regjistruar si debi në llogarinë e kthimeve të shitjeve, por regjistrimi i saktë ishte bërë në llogarinë kontrolluese të detyrimeve ndaj furnitorëve.
- iv) Pajisja me vlerë 1,600€ ishte regjistruar si debi në llogarinë e riparimeve dhe mirëmbajtjes.
- v) Shpenzimet për qira prej 4,392€ ishin regjistruar gabimisht si 4,932€ në llogarinë e shpenzimeve, por ishin regjistruar saktë në librin e arkës.
- vi) Tarifat bankare prej 160€ nuk janë regjistruar fare në regjistrat kontabël.

Kërkohet:

Bëni regjistrimet kontabël për korrigjimin e gabimeve dhe mbyllni llogarinë pezull
(10 pikë)

Regjistrimet kontabël të Albani SH.P.K.

Transaksionet	Debi	Kredi
	€	€
i) Blerjet	80	
Llogaria pezull		80
ii) Llogaria pezull	800	
Shpenzimet e telefonit		800
iii) Llogaria pezull	880	
Kthimet e blerjeve		440
Kthimet e shitjeve		440
iv) Pajisja	1,600	
Riparimet dhe mirëmbajtja		1,600
v) Llogaria pezull	540	
Shpenzimet e qirasë		540
vi) Shpenzimet e interesit	160	
Llogaria bankare		160

Llogaria pezull

2) 800	Saldo 2,140 (691,680-689,540)
	1) 80
3)880	
5) 540	
	Saldo 0

Problemi 2

Bilanci vërtetues i Kanita SH.P.K. më 31 dhjetor 2025 është si më poshtë:

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Kapitali aksionar i zakonshëm (1€për aksion)		2,940
Paraja në bankë	69	
Tatimi i pagueshëm me 1 janar 2025		75
10% notë kreditore (e ripagueshme në 2030)		900
Shpenzimet administrative	138	
Pagat administrative	72	
Shpenzimet e shpërndarjes	75	
Pagat e stafit të shpërndarjes	30	
Shpërblimi i drejtorëve	105	
Interesi i paguar i notës kreditore	45	
Kostot e zhvillimit (të shkaktuara gjatë 2025)	90	
Dividenda e paguar	90	
Te hyrat nga dividenda		60
Investime afatgjata	135	
Toka dhe Ndërtesa - me kosto	12,600	
- zhvlerësimi i akumuluar më 1 janar 2025		7,800
Makineria dhe pajisjet- me kosto	600	
- zhvlerësimi i akumuluar më 1 janar 2025		225
Fitimet e mbajtura më 1 janar 2025		192
Blerjet dhe shitjet	1,215	2,760
Fitimi nga shitja e fabrikës		180
Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet	48	300
Stoqet më 1 janar 2025	105	
Borxhet e këqija	<u>15</u>	
	15,432	15,432

Shënimet shtesë:

- i) Më 31 dhjetor 2025, stoqet kishin kosto 190,000€ ndërsa vlera neto e realizueshme ishte 165,000€.
- ii) Pasuritë jo-qarkulluese zhvlerësohen me metodën drejtëvizore , duke supozuar se nuk ka vlerë të mbetur. Të përdoren normat e mëposhtme të zhvlerësimit:

Ndërtesat : 5%

Makineria dhe pajisjet: 20%

Vlera e kostos se tokës ishte 9,600,000€.

- iii) Kostot e zhvillimit janë pasuri të paprekshme dhe duhet të amortizohen gjatë një periudhe trevjeçare.
- iv) Tatimi i pagueshëm me 31 dhjetor vlerësohet në 285,000€. Nuk janë bere pagesa te tatimit gjate vitit.
- v) Shpërblimi i drejtorëve do të ndahet midis shpenzimeve të shpërndarjes dhe shpenzimeve administrative si më poshtë:

Shpërndarja: 45,000€

Administrimi:60,000€

Kërkohe:

Përgatitni Pasqyrën e Ardhurave gjithperfshirese të Kanita SH.P.K. për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2025.

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Kanita SH.P.K.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	€'000
Të hyrat	2,760
Kostoja e shitjes (Llog.1)	<u>(1,155)</u>
Fitimi bruto	1,605
Të hyrat tjera	<u>60</u>
	1,665
Kostoja e shpërndarjes (75+45+30)	(150)
Shpenzimet administrative (LI 3)	<u>(585)</u>
Fitimi operativ	930
Fitimi në shitjen e fabrikës	180
Shpenzimet e interesit (Llog.4)	<u>(90)</u>
Fitimi para tatimit	1,020
Shpenzimet e tatimit në fitim (Llog. 5)	<u>(210)</u>
Fitimi i vitit	<u>810</u>

Kanita SH.P.K.

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2025

	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Toka dhe Ndërtesa (Llog. 2)		4,650
Makineria dhe pajisjet (Llog. 2)		<u>255</u>
Prona, impiantet dhe pajisjet		4,905
Pasuritë e paprekshme (90 - 30)		60
Investimet afatgjata		<u>135</u>
		5,100
Pasuritë qarkulluese:		
Stoqet	165	
Të arkëtueshmet	48	
Paraja	<u>69</u>	
		<u>282</u>
Total pasuritë		<u>5,382</u>
Ekuiteti dhe detyrimet		
Kapitali aksionar dhe rezervat		
Kapitali aksionar		2,940
Fitimet e mbajtura (Llog. 6)		<u>912</u>
Total ekuiteti		3,852
Detyrimet afatgjata		
10% nota kreditore e ripagueshme në 2030		900
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshmet	300	
Tatimi i pagueshëm (75 + 210)	285	
Interesi i pagueshëm mbi notën kreditore	<u>45</u>	
		<u>630</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet		<u>5,382</u>

Llogaritjet

Llog 1 $KMSH=105+1215-165=1155$

Llog 2. Pasuritë jo qarkulluese

	Toka dhe Ndërtesat €'000	Makineria dhe Pajisjet €'000
Kostoja	12,600	600
Zhvlerësimi i akumuluar:		
Më 1 janar 2025	7,800	225
Gjatë vitit		
(5% x (12,600-9,600))	150	
(20% x (600))		120
Më 31 dhjetor 2025	<u>(7,950)</u>	<u>(345)</u>
Vlera neto ne libra	<u>4,650</u>	<u>255</u>

Total shpenzimet e zhvlerësimit=270

Llog.3 Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative	138
Pagat administrative	72
Shpërblimi i drejtorëve	60
Zhvlerësimi	270
Borxhet e këqija	15
Amortizimi i kostove të zhvillimit (90/3)	30
Total	585

Llog.4 Shpenzimi i interesit

	€'000
Interesi i paguar për notën kreditore	45
Interesi i pagueshëm me 31 dhjetor (shif. bal.)	<u>45</u>
Shpenzimi i vitit (10% x 900)	90

Llog.5 Shpenzimi i tatimit

	€'000
Tatimi i pagueshëm në fillim	(75)
Tatimi i pagueshëm në fund	<u>285</u>
Shpenzimi i vitit	210

Llog.6 Fitimet e mbajtura

	€'000
Fitimi në fillim të vitit	192
Fitimi pas tatimit	810
Dividenda e paguar	<u>(90)</u>
Në fund të vitit	912

Problemi 3

Marini është ndërmarrës i vogël dhe i mesëm që merret me prodhimin dhe furnizimin e mobiljeve. Më poshtë paraqiten transaksionet e realizuara gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2025.

(a) Marini kishte saldo në fillim të akrualeve për energji elektrike në shumën 600,000€ më 1 janar 2025. Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2025, ai pagoi fatura të energjisë elektrike në total 3,060,000€. Gjithashtu e kishte marr edhe nje fature, te cilën ende nuk e ka paguar për tremujorin e ardhshëm, qe fillon më 30 nëntor 2025 në vlerë prej 840,000€.

(5 pikë)

(b) Marini bleu një makineri më 1 mars 2025 për 120,000€. Ai pati kosto shtesë për transportin në shumën 13,000€ dhe për instalimin në shumën 20,000€. Pak pasi filloi përdorimin e makinerisë, ajo u prish dhe riparimi i saj kushtoi 1,200€. Marini llogarit zhvlerësimin me normë 10% në vit, sipas metodës drejtvizore, me ngarkesë të plotë vjetore në vitin e blerjes.

(5 pikë)

(c) Më 31 dhjetor 2025, Marinit i detyrohen gjithsej 75,500€ klientët e tij. Saldo e lejimit për llogaritë e arkëtueshme ne fillim më 1 janar 2025 është 12,800€. Ai vlerëson se lejimi për llogaritë e arkëtueshme duhet të jetë i barabartë me 10% të shumës që i detyrohen klientët më 31 dhjetor 2025. Marini dëshiron të fshijë borxhe të kqija në shumën 14,000€ në lidhje me saldot e klientëve që kanë mbetur të papaguara përtej periudhës së kredisë që u është ofruar atyre.

(5 pikë)

(d) Kur Marini kreu numërimin fizik të mallrave, zbuloi se një pjesë e stokut e blerë gjatë vitit për 40,000€, ishte dëmtuar për shkak të lagështisë në depo. Një shqyrtim më i detajuar i stoqeve tregoi se ai mund të shitej vetëm me një çmim 30% më të ulët se çmimi normal i shitjes prej 50,000€.

(5 pikë)

Kërkohet:

Llogaritni dhe shpjegoni shumat e nevojshme që duhet të paraqiten në Pasqyrën e te Ardhurave Gjithëpërfshirëse dhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025.

(Total:20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

(a) Marini kishte një saldo fillestare të akrualeve në shumën 600,000€ në fillim të vitit, e cila duhet të zbritet nga shuma e paguar gjatë vitit. Ai gjithashtu kishte akrualet për një muaj në fund të vitit ($840,000 \times 1/3$), që arrin në 280,000€. Andaj

Saldo e akrualeve në fund	280,000
Shto, shumat e paguara gjatë vitit	3,060,000
Zbrit saldot e akrualeve në fillim	<u>(600,000)</u>
Shuma që shkon në pasqyrën e te ardhurave	<u>2,740,000</u>

Shuma që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrim afatshkurtër është 280,000€.

Llog.1	
Të arkëtueshmet në fund të vitit	75,500
Zbrit borxhin e paarkëtueshëm	(14,000)
Të arkëtueshmet neto në fund të vitit	61,500
Saldo e lejimeve në fund të vitit (10%*61,500)	(6,150)
Minus saldo ne fillim e lejimeve	(12,800)
Ulje e lejimeve gjatë periudhës	6,650

- (b) Kostoja fillestare përbëhet nga kostoja e blerjes (120,000€), kostoja e transportit (13,000€) dhe kostoja e instalimit (20,000€), duke arritur gjithsej 153,000€. Këto konsiderohen pasuri afatgjata.
- Kostoja e riparimeve prej 1,200€ nuk do të përfshihet në koston fillestare të makinerisë, pasi është shpenzim operativ.
 - Prandaj, 1,200€ do të regjistrohen si shpenzim në Pasqyrën e te Ardhurave.
 - Totali i koston 153,000€ do të zhvlerësohet me normë 10%, duke rezultuar në një shpenzim të plotë zhvlerësimi për Pasqyrën e te Ardhurave prej 15,300€ (10% × 153,000€).
 - Vlera e pasurisë që do të shfaqet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar do të jetë 137,700€ (153,000€ – 15,300€).
- (c) Totali që do të raportohet në Pasqyrën e te Ardhurave (Llog.1) do të jetë 7,350€ (14,000 shpenzimet nga borxhet e kqija – 6,650 Te hyrat nga borxhet e dyshimta). Totali i llogarive të arkëtueshme që do të paraqitet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar do të jetë 55,350€ (61,500 – 6,150).
- (d) SNK 2 Stoqet kërkon që stoqet të vlerësohen në vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme (VNR). Artikulli i stokut në fjalë, me kosto 40,000€, kishte një vlerë neto të realizueshme prej 35,000€, që është më e ulët se kostoja. Kjo do të thotë se kostoja e shitjeve ishte nënvlerësuar për shkak të stokut të lartë në fund të vitit dhe duhet të rritet, duke ulur fitimin me diferencën prej 5,000€. Prandaj, Pasqyra e te Ardhurave do të ngarkohet me 5,000€, si humbje nga rënia ne vlere e stoqeve. Stoqet që do të paraqiten në Pasqyrën e Pozicionit Financiar duhet të njihen në shumën 35,000€.

Problemi 4

Mirani SH.P.K. është furnizues i pajisjeve elektrike që po planifikon të zgjerojë biznesin e tij në qytete të tjera. Menaxhmenti i tij ka kontaktuar bankën për financim shtesë. Si një nga kushtet për financimin, banka ka kërkuar nga Miran SH.P.K. të dorëzojë pasqyrën e rrjedhës së parasë përveç pasqyrës së të ardhurave dhe pasqyrës së pozicionit financiar.

Më poshtë paraqiten draft pasqyrat financiare të Miran SH.P.K.

Pasqyra e e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 mars 2025

	€'000
Shitjet	2,324
Kostoja e shitjeve	<u>(1,732)</u>
Fitimi bruto	592
Kostoja e shpërndarjes	(94)
Shpenzimet administrative	<u>(206)</u>
Fitimi operativ	292
Te hyrat nga interesi	158
Shpenzimet e interesit	<u>(110)</u>
Fitimi para tatimit	340
Shpenzimi i tatimit në fitim	<u>(48)</u>
Fitimi i vitit	292

Pasqyra e Pozicionit Financiar e Miran SH.P.K. më 31 mars:

	2025	2024
	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese:		
Prona, impiantet dhe pajisjet	2,184	1,336
Pasuritë qarkulluese:		
Stoqet	492	256
Të arkëtueshmet tregtare	920	746
Paraja dhe ekuivalentët e saj	<u>1,054</u>	<u>716</u>
Total pasuritë qarkulluese	<u>2,466</u>	<u>1,718</u>
Total pasuritë	<u>4,650</u>	<u>3,054</u>
Ekuiteti dhe detyrimet:		
Ekuiteti:		
Kapitali aksionar (0.40€)	58	48
Premia në aksione	894	754
Teprica e rivlerësimit	502	-
Fitimet e mbajtura	<u>232</u>	<u>52</u>
	<u>1,686</u>	<u>854</u>
Detyrimet afatgjata:		
Nota kreditore	<u>1,510</u>	<u>1,110</u>
Detyrimet afatshkurtra:		
Të pagueshmet tregtare	488	622
Overdrafti bankar	874	414
Tatimi i pagueshëm	<u>92</u>	<u>54</u>
Total detyrimet afatshkurtra	<u>1,454</u>	<u>1,090</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet:	<u>4,650</u>	<u>3,054</u>

Informata shtesë:

- (1) Miran SH.P.K. ka ngarkuar zhvlerësimin mbi prona, impiantet dhe pajisjet në shumën 44,000€. Kjo shumë është përfshirë në shpenzimet administrative.
- (2) Gjatë vitit që përfundon më 31 mars 2025, Miran SH.P.K., në përpjekje për të siguruar më shumë financim për zgjerimin e biznesit, shiti një pjesë të prona, impiantet dhe pajisjet. Pasuria kishte një kosto prej 2,928,000€ dhe një vlerë kontabël prej 848,000€ dhe u shit për 500,000€.
- (3) Gjatë vitit që përfundon më 31 mars 2025, Miran SH.P.K. ka paguar dividendë prej 112,000€ për aksionarët e vet.
- (4) Miran SH.P.K. ka emetuar 25,000 aksione me një premi prej 5.60€ për aksion. Çmimi nominal i çdo aksioni ishte 0.40€.

Kërkohet:

- (a) Përgatitni pasqyrën e rrjedhës së parasë të Miran SH.P.K. për vitin që përfundon më 31 mars 2025. (18 pikë)
 - (b) Shpjegoni dy (2) përfitime të përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë. (2 pikë)
- (Total:20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

Pasqyra e rrjedhës së parasë e Miran SH.P.K. për vitin që përfundon më 31 mars 2025.

	€'000	€'000
Rrjedhja e keshit nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	340	
Rregullimet për: Shpenzimet e zhvleresimit	44	
Humbja nga shitja e pajisjes (llog.1)	348	
Shpenzimet e interesit	110	
Te hyrat nga interesi	<u>(158)</u>	
	684	
Rritja e stoqeve (492-256)	(236)	
Rritja në të arkëtueshmet tregtare (920-746)	(174)	
Zvogëlimi në të pagueshmet tregtare (488-622)	<u>(134)</u>	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	140	
Interesi i paguar	(110)	
Tatimi i paguar (Llog.3)	(10)	
Rrjedhja neto e keshit prej aktiviteteve operative		20
Rrjedhja e keshit nga aktivitetet investuese		
Blerja e PIP (Llog.1)	(1,238)	
Shitja e PIP	500	
Interesi i arkëtuar	158	mund te paraqitet edhe tek A.operative
Rrjedhja neto e keshit prej aktiviteteve investuese		(580)
Rrjedhja e keshit nga aktivitetet financuese		
Të ardhurat nga emetimi i aksioneve(58+894-48-754)	150	
Emetimi i notes (1,510-1,110)	400	
Pagesa e dividendës	(112)	
Rrjedhja neto e keshit nga aktivitetet financuese		438
Zvogëlimi neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë gjatë periudhës		(122)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim (716-414)		302
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund (1,054-874)		180

Llogaritjet

1. Blerja e PIP

	€'000		€'000
Saldo në fillim	1,336	Shitja (vlera kontabël)	848
Teprica e rivlerësimit	502	Shpenzimi i zhvlerësimit	44
Blerja (shifër balancuese)	<u>1,238</u>	Saldo në fund	<u>2,184</u>
	<u>3,076</u>		<u>3,076</u>
Fitimi ose humbja nga shitja			
	'000		
Vlera kontabël	848		
Të ardhurat nga shitja	<u>500</u>		
Humbja në shitje	<u>348</u>		

2. Paraja dhe ekuivalentët e saj

	2025	2024
	€'000	€'000
Paraja dhe ekuivalentët e saj	1,054	716
Overdrafti bankar	<u>(874)</u>	<u>(414)</u>
Total paraja dhe ekuivalentët e saj	<u>180</u>	<u>302</u>

Zvogëlimi në paraja dhe ekuivalentët e saj 122 (302-180)

3. Tatimi i paguar

	€'000	
Saldo në fillim (tatimi I pagueshëm)	54	
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>48</u>	
		102
Zbrit saldon në fund (tatimi I pagueshëm)	<u>92</u>	
Tatimi i paguar	<u>10</u>	

(a) Përfitimet e përgatitjes së një pasqyre të rrjedhjes së parasë

- I. Mundëson vlerësimin e aftësisë së një biznesi për të gjeneruar para, që është një përbërës kritik për mbijetesën e një biznesi. Mund të thuhet se paratë e gatshme konsiderohen si një katalizator thelbësor i operacioneve të një biznesi.
- II. Një pasqyrë e rrjedhjes së parasë është më gjithëpërfshirëse në nxjerrjen e aktiviteteve të raportuara të lidhura me mjete monetare sesa pasqyra e të ardhurave, e cila shpesh përgatitet bazuar në konventat dhe konceptet e kontabilitetit si aktual.
- III. Pasqyrat e rrjedhjes së parasë matin më mirë aftësinë e një biznesi për të përmbushur detyrimet e tij sesa një pasqyrë e të ardhurave.
- IV. Aftësia e një entiteti për të shpërblyer aksionarët ose për të paguar punonjësit në mënyrë konkurruese vlerësohet më mirë nga pasqyrat e rrjedhës së parasë të kompanisë.

Problemi 5

Sing ka blerë 80% të ekuitetit të Kit më 1 janar 2025 për 120,000€ kur fitimet e mbajtura të Kit ishin 50,000€. Vlerat drejtë e interesit jo-kontrollues në atë datë ishte 40,000€. Gjatë vitit Sing i shiti Kit-it mallra që kushtonin 80,000€, me një kosto të faturuar prej 100,000€. Kit kishte 50% të mallrave ende në stoqe në fund të vitit. Draft pasqyrat financiare të dy kompanive më 31 dhjetor 2025 janë si vijon:

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2025

	<i>Sing</i>	<i>Kit</i>
	€000	€000
Të hyrat	5,000	1,000
Kosto e shitjeve	<u>2,900</u>	<u>600</u>
Fitimi bruto	2,100	400
Shpenzimet e tjera	<u>1,700</u>	<u>320</u>
Fitimi para tatimit	400	80
Tatimi	<u>130</u>	<u>25</u>
Fitimi i vitit	<u>270</u>	55

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE MË 31/12/2025

	<i>Sing</i>	<i>Kit</i>
	€'000	€ '000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Investimet në Kit	120	-
Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme	1,880	200
	<u>2,000</u>	<u>200</u>
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	500	120
Llogaritë e arkëtueshme	650	40
Paraja në bankë	<u>390</u>	<u>35</u>
	<u>1,540</u>	<u>195</u>
	<u>3,540</u>	<u>395</u>
<i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar	2,000	100
Fitimi i mbajtur	<u>400</u>	<u>200</u>
	2,400	300
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Llogaritë e pagueshme	910	30
Tatimi	<u>230</u>	<u>65</u>
	<u>1,140</u>	<u>95</u>
	<u>3,540</u>	<u>395</u>

Kërkohet

Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e pozitës financiare të konsoliduar të Grupit Sing më 31 dhjetor 2025. (Totali 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

GRUPI SING

PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN QË MBARON MË 31 DHJETOR 2025

	€'000
Të hyrat (5,000 + 1,000 - 100*)	5,900
Kosto e shitjeve(2,900 + 600 - 100* + 10(LL2))	<u>3,410</u>
Fitimi bruto	2,490
Shpenzimet e tjera (1,700 + 320)	<u>2,020</u>
Fitimi para tatimit	470
Tatimi (130 + 25)	<u>155</u>
Fitimi i vitit	<u>315</u>
<i>Fitimi i atribuohet:</i>	
Mbajtësve të ekuitetit të kompanisë mëmë (sh.bal.)	304
Interesi jo-kontrollues (20% x €55,000)	<u>11</u>
* Largo tregtinë brenda grupit	<u>315</u>

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZITËS FINANCIARE MË 31 DHJETOR 2025

	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Zëri i mirë (LL1)	10	
Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme (1,880 + 200)	<u>2,080</u>	
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet (500 + 120 - 10(LL2))	610	
Llogaritë e arkëtueshme (650 + 40)	690	
Paraja në bankë (390 + 35)	<u>425</u>	
		<u>1,725</u>
		<u>3,815</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë</i>		
Kapitali aksionar (vetëm Sing)		2,000
Fitimi i mbajtur (LL3)		<u>510</u>
		2,510
Interesi jo-kontrollues (LL4)		<u>70</u>
Total ekuiteti		2,580

Detyrimet afatshkurtra

Llogaritë e pagueshme (910 + 30)	940	
Tatimi (230 + 65)	<u>295</u>	
		<u>1,235</u>
<i>Total ekuiteti dhe detyrimet</i>		<u>3,815</u>

Llogaritjet

1	<i>Zëri i mirë</i>	€'000	€'000
	Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		120
	Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje		40
	Minus vlera e drejtë neto e pasurive të identifikueshme të blera të përfaqësuara nga:		
	Kapitali aksionar	100	
	Fitimet e mbajtura	<u>50</u>	
			<u>(150)</u>
	<i>Zëri i mirë</i>		<u>10</u>
2	<i>Kalkulimi për fitimin e perealizuar</i>		€
	Fitimi nga tregtia brenda grupit (100,000 – 80,000)		20,000
	Fitimi i pa-realizuar (50% × 20,000)*		10,000
	* 50% e mallrave nga tregtia brenda grupit mbetet në stoqe në fund të vitit, për këtë arsye fitimi i pa-realizuar është 50% e fitimit total nga tregtia brenda grupit. Pjesa tjetër e fitimit nga tregtia brenda grupit realizohet tani pasi që mallrat janë shitur jashtë grupit.		
3	<i>Fitimet e mbajtura</i>	<i>Sing</i>	<i>Kit</i>
		€'000	€'000
	Sipas pyetjes	400	200
	Fitimi i pa-realizuar (LL2)	(10)	
	Fitimet e mbajtura para blerjes		<u>(50)</u>
			<u>150</u>
	Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
	Kit (80% × 150)	<u>120</u>	
	Fitimet e mbajtura të grupit	<u>510</u>	

4	<i>Interesi jo-kontrollues në datën e raportimit</i>	€'000
	Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes	40
	Plus pjesa e IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (20% × 150)	<u>30</u>
	IJK në datën e raportimit	<u>70</u>